



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 339 Prot.

Tiranë, më 19.04.2016

V E N D I M

Nr. 43, datë 19/04/2016

“Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2016, me procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 143, datë 06.01.2016, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2016”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i “mbikëqyrjes së orientuar”, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2016.

Për këtë arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit si dhe në zbatim të Vendimit nr. 143, datë 06.01.2016, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2016”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në

administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t'u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2016,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t'u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2016.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

1. Altin SHUMELI	Drejtor i Mbikëqyrjes (<i>Drejtues teknik</i>)
2. Saimir MUÇMATAJ	Inspektor (<i>Përgjegjës grupi</i>)
3. Irma VANI	Inspektor (<i>Anëtar</i>)
4. Ina SKËNDERI	Specialist IT (<i>Anëtar</i>)

2. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
3. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA